



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 27/18
Prishtinë, më 20.6.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Jelena Bontiq, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Blerim Kuçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Fikrim Damka.

Munguan: Dardan Molliqaj dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Emrush Haxhiu, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës së Kuvendit; Istret Azemi, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa të Administratës së Kuvendit; Vlorë Berisha, anëtare e Komisionit të Pavarur për Media (KPM); Arben Bilalli dhe Ganimete Nuçi, KPM; Musa Shabani, kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM); Festim Kutllovci, Azem Rexhaj, Avdi Konjuhi dhe Kemajl Zeqiri, anëtarë të Bordit të KPMM-së; Haradin Gërvalla, kryesues i Departamentit të Financave në KPMM; Kreshnik Gashi, kryetar i Bordit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Ilir Imeri, Ramiz Krasniqi dhe Fatmir Gërvalla, ARKEP; Emine Fazliu, Valbon Bytyçi, Faruk Rrahmani dhe Ramadan Gashi, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Pjesëmarrës tjerë: Qëndrim Badalli, KDI dhe Mentor Hyeni, GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurie Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit, Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore 2019/01 të Kuvendit të Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit Pavarur për Media për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2017;**

6. Shqyrtimi i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe amendamentet e komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
11. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 /L-010 për Noterinë dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që të bëhet një rirenditje e pikave të rendit të ditës dhe pikat 6-11, të shqyrtohen fillimisht, pastaj të tjerat me radhë.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua unanimisht, me ndryshimin e renditjes së pikave të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projekt-kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu, as amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligji nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut dhe amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu, as amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe amendamenti i propozuar nga deputetët Duda Balje dhe Bahrim Shabani, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut, amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe amendamenti i propozuar nga deputetët Duda Balje dhe Bahrim Shabani, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe dhe amendamentet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu, as amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligji nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe amendamentet e komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. As amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligji nr. 06/L-038 për shërbimet postare dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji përmban implikime buxhetore shtesë. Por, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, kostoja është zvogëluar në 100,000 euro, që mendoj se është e përballueshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimitisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06 /L-010 për Noterinë dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari theksoi se në bazë të deklaratës së vlerësimit financiar të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave, projektligji përmban implikime buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional, Grupi Parlamentar Lista Serbe dhe amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar 6+, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim:

Projektligjit nr. 06 /L-010 për Noterinë, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës Serbe dhe amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar 6+, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore 2019/01 të Kuvendit të Kosovës

Kryetari: Po ua jap fjalën përfaqësuesve të administratës së Kuvendit për prezantimin e kërkesave buxhetore dhe pastaj hapim diskutimin.

Emrush Haxhiu: Kërkesat buxhetore të Kuvendit, në kuadër të Qarkores së parë buxhetore, janë në pajtueshmëri të plotë me kornizën afatmesme të shpenzimeve që është miratuar në kuadër të komisionit dhe në Kryesi dhe është proceduar në Ministrinë e Financave. Gjithashtu, në kuadër të planifikimeve, kërkesat tona buxhetore janë miratuar nga Ministria e Financave, përveç dy rasteve që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, që kohëve të fundit ka dalë si aktivitet shtesë që Kuvendi i Kosovës të mund të marrë kryesimin e presidentes së asamblesë parlamentare për procesin e bashkëpunimit të Evropës Juglindore, e që ka implikimin buxhetor, përafërsisht 120.000 euro për vitin 2019 dhe vitin 2020. Gjithashtu, për shkak të ndryshimeve që janë bërë, në kuadër të strukturës së grupeve parlamentare, ka ndikuar që të ketë implikime financiare shtesë për dy stafe politike, për shkak se është formuar një grup i ri parlamentar, por edhe për shkak të kalimit të deputetëve nga një grup në tjetrin.

Kryetari: Më intereson fakti se vitin e kaluar në buxhet, ne kemi shtuar stafin administrativ për Komisionin për Buxhet dhe Financa, buxheti është ndarë dhe ende nuk kemi rekrutimin e tyre.

Emrush Haxhiu: Ende nuk kemi rekrutim, sepse kemi disa probleme me Ministrinë e Administratës Publike, por kemi edhe një pengesë në kuadër të Administratës së Kuvendit, sepse drejtori i Drejtorisë së Personelit që ka qenë më herët, ka liruar vendin e punës dhe deri të zgjidhet drejtori i ri, ka ndikim edhe në këtë aspekt, meqenëse ka filluar procedura dhe gjatë këtij viti do të bëjmë zgjidhje me rekrutimin e këtyre pozitave.

Mërgim Lushtaku: Kur kemi votuar buxhetin e Kosovës, lidhur me kërkesat e Kuvendit, kemi parë që vazhdimisht ka shpenzime marramendëse, te formati i letrave që ne si deputetë, vazhdimisht kemi

ankesa në këtë drejtim. Kërkoj që, në një farë forme, të digjitalizojmë të gjitha materialet e mos të na vijnë edhe në formën elektronike dhe fizike. Ne kemi paraparë të ndajmë një buxhet të veçantë për implementimin e sistemit elektronik të komunikimit dhe mua intereson ju si Administratë e Kuvendit, sa keni bërë në këtë drejtim?

Emrush Haxhiu: Ne, si Administratë e Kuvendit, kemi filluar implementimin e një projekti për një platformë që quhet “e Parlamenti”, i cili është në procedim e sipër. Sa i përket pajisjeve që deputetët kanë përfituar në çdo legjislaturë, kësaj radhe jemi me vonesë, për arsye se Ligji i prokurimi publik ka paraparë prokurimet qendrore që të kryhen nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, dhe në kuadër të kësaj, edhe pajisjet që janë paraparë për deputetë, janë në procedurë tek AQP-ja. Pra, jemi në pritje ende, por nuk ka ndonjë informatë tjetër. Sa i përket posedimit të letrës, është një çështje e vendosjes të organeve të Kuvendit, ku duhet të parashihet edhe me rregullore mënyra e funksionimit të tillë.

Mërgim Lushtaku: Lidhur me këtë, bëjeni një kërkesë që të bëhet një sallë për deputetë, ku laptopët të mos merren prej deputetëve, por të jetë sistemi i digjitalizuar që gjithëherë të përcjellë materialet. Sa i përket digjitalizimit aktual të administratës, sidomos në Kuvend, unë personalisht dhe shumica e deputetëve kanë shumë vështirësi në qasje. Nëse nuk e planifikoni këtë hap në këtë vit, së paku vitin e ardhshëm ta rregullojmë.

Emrush Haxhiu: Kur bëhet fjalë për këto çështje, domosdoshmërisht implikohet edhe infrastruktura e Kuvendit. Sa i përket sallave për komisione, nuk kemi salla që janë të veçanta për secilin komision, që kishim mundur të instalojmë edhe pajisjet dhe çdo gjë për komisione, mirëpo vazhdimisht ndërrohen sallat.

Kryetari: A keni ndonjë ide ose hapësira planifikuese për personat që punojnë në Kuvend? Me sa shoh unë, asnjë deputet nuk ka zyrë dhe kjo duhet të rregullohet.

Safete Hadërgjonaj: Unë jam deputete për 14 vite me radhë dhe kurrë nuk pata një vend për t’i vendosur dokumentet e mia në Kuvend. Na është thënë këtu në komision se kur të dalin të Ministrisë së Transportit, atëherë ju menjëherë do të keni mundësi nga 4 deputetë të akomodohen në një zyrë dhe kjo nuk ka ndodhur. Por ashtu, kur dalin këto agjencitë e pavarura, të cilat janë këtu në Kuvend, do të ndodhë ajo dhe tash sigurisht është arsyetimi se kur të dalë Presidenca.

Mirëpo, vërtet është shqetësuese për Kuvendin. Ne i kemi bërë zyrë makinat, në të cilat duhet t’i lëmë materialet vazhdimisht dhe fatkeqësia është kur nuk ke ku ta printosh një letër, kur ke për të diskutuar diçka ose nuk ke ku të ulësh për të shkruar një koncept në kompjuter dhe kjo nuk i intereson askujt në Kuvend dhe është shumë shqetësuese kjo çështje.

Emrush Haxhiu: Sa i përket investimeve kapitale, aktualisht, struktura e Kuvendit është kjo që është, duke marrë parasysh që këtu është edhe Presidenca dhe ka zënë një hapësirë dhe ne jemi munduar, sipas mundësive, ta kemi hapësirën në dispozicion dhe të bëjmë zgjidhje. Ndërkaq, sa i përket vendosjes së deputetëve dhe grupeve parlamentare në zyra, me Rregullore, vendos Kryesia për akomodimin e tyre. Ne kemi bërë propozime disa herë dhe Kryesia asnjëherë nuk është marrë seriozisht me këtë çështje dhe kemi arritur në këtë situatë të cilën ju po e trajtoni si jo të rregullt, mirëpo këto janë mundësitë tona. Megjithatë, janë shpërndarë zyra, në kuadër të grupeve parlamentare, sesi i kanë vendosur deputetët në zyrë, është përgjegjësi e tyre. Sa i përket numrit të stafit që janë përfshirë në grupet parlamentare, me vendim të Kryesisë dhe me rekomandim prej këtij komisioni, janë vendosur duke pasur parasysh fuqinë që ka grupi parlamentar dhe paga është përcaktuar fikse 700 euro, koeficienti është 7 diku rreth 420 euro, mirëpo arrihet paga prej 700 euro, me shtesat që marrin.

Safete Hadërgjonaj: *Një çështje tjetër që më intereson, është se si e keni planifikuar buxhetin dhe pagat për këta këshilltarët e rinj të grupeve parlamentare? Ne, në komision, e kemi marrë një vendim që paga e tyre të jetë diku 800 euro, kurse realiteti është që ata janë me një koeficient 7. Nuk mendoj se është një zgjidhje e mirë si i keni përcaktuar pagat, sepse të vijnë për të punuar dhe bëjnë hulumtime brenda grupit me një pagë të tillë, është e pamundur.*

Naser Osmani: Unë propozoj që kur të vijë sekretari, të diskutojmë për çështjen e pagesës së këshilltarëve në grupe parlamentare. Ata nuk mund të financohen me kurrfarë koeficienti, sepse ata i përzgjedh vetë partia dhe nuk mund të trajtohen si shërbyes civil. Ne kemi caktuar një pagë bazë, ku këta vetëm duhet zbatuar e jo ta shndërrojnë në koeficient.

Kryetari: Deri në trajtimin e qarkores së dytë, rekomandoj që të jemi më shumë kërkues në investimet kapitale. Ndërsa, tani t'i rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit, të miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit 2019-2021, dhe njëkohësisht, të rekomandojmë që Kryesia të vendosë për ndarjen e zyrave për punë për deputetë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni për Kryesinë e Kuvendit, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim:

- I. Të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2019-2021, sipas dokumentit të bashkëngjitur këtij rekomandimi dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019-2021.
- II. Kryesia e Kuvendit, të vendosë për ndarjen e zyrave për punë për deputetë.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017

Kryetari përshëndeti të pranishmit. Theksoi se ne kemi ftuar edhe Zyrën e Auditorit, për të shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017 dhe raportet tjera që kemi në rend dite.

Arben Bilalli: KPM-ja, me gjithë vështirësitë që i ka si organizatë buxhetore dhe me të gjitha sfidat e reja që po i arrin teknologjia në këtë kohë, në bazë të analizës së auditorit dhe nga zyra kemi pasur një performancë të mirë. Buxheti i miratuar i KPM-së ishte në total 1.214.000 euro dhe meqë ka qenë edhe një projekt kapital për ndërtim të objektit dhe KPM-ja ka bërë një memorandum me Ministrinë e Administratës Publike që nuk ka kapacitete për ndërtimin e atij objekti dhe i kemi bartur këto mjete në MAP, me rishikimet buxhetore. Sa i përket kategorive ekonomike, për paga kemi arritur një performancë prej 95%, mallra dhe shërbime 95% dhe në komuna 95%.

Emine Fazliu: ZKA ka publikuar raportin e auditimit për pasqyrat financiare të KPM-së dhe ka dhënë një opinion të pamodifikuar, që do të thotë se pasqyrat paraqesin një pamje të saktë dhe të vërtetë. Në këtë raport kemi dhënë 6 rekomandime që ndërlidhen me paga dhe mëditje, mallra e shërbime, harxhim të pasurive, si dhe mosmiratimin e planit strategjik. Mirëpo, dua të cek një sfidë që e përcjell KPM-në, e cila është rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtuara. Edhe pse KPM është munduar që këto llogari të shkojnë te Gjykata dhe përmbaruesi për kompensim, përsëri inkasimi i tyre është shumë i ulët.

Arben Bilalli: Ne, si KPM, nuk kemi ndonjë mekanizëm të veçantë për të mbledhur inkasimin tonë, kjo është taksa e licencës, duke pasur parasysh që e kemi televizionin publik, tashmë është hyrë në vitin e tretë që nuk e ka paguar taksën. Ajo na rrit neve më shumë borxhin, pra ne nuk mund t'ua tërheqim licencën ose t'i japim gjobë televizionit publik, sepse ekziston një ligj i veçantë për të. Mirëpo, pas këtij viti, arkëtimet kemi filluar t'i realizojmë me përmbarues dhe besoj që në vijim do të rregullohet.

Blerim Kuçi: Duke iu referuar raportit të pamodifikuar për vitin 2017, a mund të shohim se çfarë ka qenë opinioni dhe rekomandimet e ZKA-së për vitin 2016?

Emine Fazliu: Raporti i auditimit për vitin 2016, për KPM-në, ka qenë opinion i përmbajtur, ndërsa ky raport ka përmbajtur 6 rekomandime, ku prej tyre, 4 janë zbatuar, 1 është në proces dhe 1 rekomandim nuk është adresuar ende. Rekomandimi, i cili nuk është zbatuar ende, është: “Kryetari i komisionit të KPM-së duhet të ndërmarrë veprime për të ndërprerë praktikën e mbulimit të pozitive me ushtrues detyre”.

Arben Bilalli: Dy rekomandimet e auditorit, njëra, tani është adresuar, pra është fjala për strategjinë e cila në bazë të ligjit për digjitalizim, që shkon Qeverisë për miratim, të cilën e kemi dërguar tri herë në Qeveri, mirëpo kjo e fundit nuk e ka miratuar. Sa i përket ushtruesit të detyrës, në vitin 2016, kemi pasur një zyrtar, i cili ka shkuar për doktoratë në Kroaci dhe vendi i punës është pezulluar, ne është dashur ta bëjmë një ushtrues detyre për plotësimin e atij vendi të punës. Ne kemi problem edhe me rekrutimin e stafit.

Blerim Kuçi: Jo rastësisht e ceka çështjen e rekomandimeve, sepse ka të bëjë me hallkën e rekomandimeve, në qoftë se rekomandimi i institucionit përkatës nuk është zbatuar për shkak të një hallke tjetër, qoftë Ministria e Administratës Publike apo ajo e Financave, atëherë auditori i përgjithshëm është i detyruar të gjejë hallkën se ku është problemi, sepse çështja e zbatimit të rekomandimeve është çështje shumë me rëndësi.

Kryetari: A keni marrë përgjigje prej Administratës Publike, pse nuk po jepet miratimi për rekrutimin e stafit të ri, dhe për këtë çështje, Komisionit funksional që i raportoni për raport të punës, a kanë dhënë rekomandim në ministri?

Arben Bilalli: Ministria e Administratës Publike ende nuk ka dhënë rekomandim, kanë kërkuar dokumente shtesë, si përshkrim të detyrave të punës dhe ne i kemi dorëzuar të gjitha. Nëse më lejohet të përmend edhe një çështje, ne kemi komisionin dhe bordin, që janë të emëruar nga Kuvendi dhe ne marrim vërejtje pse kemi mbingarkesë të punëtorëve dhe kemi problem me Ministrinë e Financave, pasi që të njëjtit figurojnë në numër të punëtorëve tanë, por nuk janë punëtorë të KPM-së.

Blerim Kuçi: Ka të bëjë me një problem tjetër që quhet komunikimi intern, mes institucioneve dhe cilido dokument që nuk e rregullon këtë komunikim intern, në formën e duhur, atëherë çdoherë fajtori është kujdestar. Ne do të kemi shumë punë në këtë proces, pra për të gjetur përgjegjësinë, mirëpo duhet mësuar që të zbatohen rekomandimet e auditorit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni për Kuvendin, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017.

10. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Komisionit Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017

Kryetari ua dha fjalën përfaqësuesve të KPMM-së, për një prezantim të shkurtër të raportit, më pas do të kalojmë në diskutim të hapur.

Musa Shabani: Në vitin 2017, janë mbledhur gjithsej 31.229.252 euro nga KPMM. Buxheti final i miratuar ka qenë 1.350.981 euro, përderisa është realizuar në përqindje 95.65% apo 1.292.227.30 euro. Inspektorati i Minerave ka bërë 76 inspektime në këta operues ilegalë, dhe gjatë atij viti, nga KPMM-ja janë bërë 80 kallëzime penale në prokurori. Po ashtu, përveç kësaj dukurie jashtëzakonisht negative, kërkojmë nga ju që t'i bashkërendisim planet për ndalimin e kësaj dukurie, sepse kjo po ndikon në masë të madhe edhe në buxhetin e Kosovës, e sipas një analize që e ka bërë KPMM-ja, diku rreth 10 % e buxhetit të tërësishëm ndikon në të hyrat e këtij komisioni.

Azem Rexha: KPMM-ja ka arritur të realizojë buxhetin rreth 95%. Projektet kapitale, nuk kemi arritur t'i realizojmë, për shkak që gjatë punës së KPMM-së, kemi vërejtur se kanë ndryshuar prioritetet dhe mjetet janë kthyer në Ministrinë e Financave. Gjatë vitit 2017, disa shpenzime kanë qenë të larta, ku kemi tentuar të bëjmë një ulje, siç kanë qenë shpenzimet për mirëmbajtje, ato të derivateve. Sa i përket inkasimit të të hyrave e kemi kaluar planifikimin, megjithatë shqetësimi ynë është që nuk kemi arritur që të kemi 100% grumbullimin e borxheve, pra shumica prej tyre i kemi nga operimet ilegale, edhe pse në këtë pjesë ka filluar të funksionojë grumbullimi i detyrueshëm përmes përmbaruesit. Gjatë vitit 2017, borxhet totale të krijuara kanë qenë rreth 3.600.000 euro, nga këto, mbi 2 milionë euro janë borxhe të krijuara nga Trepça dhe Feronikeli. Shumica e borxheve janë shumë të vjetra, andaj edhe përmbaruesi nuk po ka sukses, sepse shumica prej tyre nuk po funksionojnë më. Kemi filluar edhe konfiskime financiare për rehabilitim në raste që kompanitë nuk e bëjnë rehabilitimin e zonës.

Emine Fazliu: ZKA ka publikuar raportin e pasqyrave financiare të KPMM-së për vitin 2017 dhe pasqyrat paraqesin një pamje të pamodifikuar dhe reale. Kemi dhënë 6 rekomandime. Niveli i realizimit të buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe inkasimi i të hyrave është 2 % më i lartë, ndërkaq si sfida është ngritja e nivelit të llogarive të arkëtueshme. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, në vitin e kaluar janë dhënë 7 rekomandime, dy janë zbatuar plotësisht, 1 është në proces dhe 4 rekomandime nuk janë zbatuar.

Kryetari: Pse këto 4 rekomandime të auditimit nga viti paraprak nuk janë përmbushur dhe a keni ndonjë plan të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve?

Azem Rexha: Shumica e këtyre rekomandimeve që nuk janë zbatuar është për faktin se KPMM-ja e ka të pamundur zbatimin komplet të tyre, për shkak që shumica e këtyre bizneseve janë mbyllur. Sa i përket ndalimit të operimeve ilegale, përkundër veprimeve që i kemi bërë, në anën tjetër, kompanitë e njëjta shpërblehen nga Qeveria për shtrimin e rrugëve apo shesin thëngjill te shkollat. Ne i kemi dërguar lëndët në prokurori, por është e pamundur të ndalojmë punën e tyre nga ana e KPMM-së.

Kryetari: Fatkeqësisht, rekomandimet tjera nuk janë të natyrës financiare, andaj komisioni ynë merret vetëm me rekomandime financiare, e i kësaj natyre, përveç inkasimit të taksave, të tjera nuk paska. Në raport nuk ka vërejtje, përveç mënyrës së shpenzimit të karburanteve 100%, mirëpo më pas u adresua që keni mungesë të karburanteve, pra qenka e arsyeshme.

Fikrim Damka: Mua më intereson te mallrat dhe shërbimet, udhëtimet jashtë vendit janë 18.500 euro, mëditjet 2500 euro , akomodimi 10.000 euro, mirëpo ky 33.000 euro, te shpenzime tjera, çfarë është?

Haradin Gërvalla, sqaroi se te shpenzimet tjera, hyjnë biletat, shpenzimet e udhëtimit, të gjitha shpenzimet tjera, ushqimi dhe këto më lart. Ka të bëjë me pjesëmarrjen e konferencave.

Safete Hadërgjonaj: Dua të dimë se për çfarë konferencash bëhet fjalë dhe kërkoj nga ju që të na dërgoni informatat për krejt shpenzimet për të gjitha udhëtimet që janë bërë jashtë vendit, në mënyrë të specifikuar.

Azem Rexha: Konferenca që është mbajtur në Toronto, ka një kosto më të lartë, ku kemi përfaqësuar Republikën e Kosovës.

Kryetari: Ju si bord, a e keni trajtuar çështjen e shpenzimeve jashtë vendit, sepse është e pakuptimtë?

Musa Shabani: Realisht, kemi edhe një tabelë të shprehur në detaje për udhëtimet jashtë vendit.

Blerim Kuçi: Ajo që dua të cek, është çështja e të hyrave te renta minerale, sa po ndikon kjo çështja e ndërtimit të rrugëve?

Azem Rexha, sqaroi se renta e të hyrave, ka një ndikim apo një rritje pozitive, sepse kompania që po merret me ndërtimin e rrugës e blen lëndën e parë nga kompanitë e licencuara dhe vetë fakti ndikon direkt në rritjen e rentës minerale.

Kryetari: Sa për informim, dokumenti që sapo mora, e qartëson atë shifrën prej 31.000 euro, ku një konferencë në SHBA është 14.000 euro, në Suedi 8.000 euro. Mendoj se janë disa shuma të larta dhe ne si rekomandim duhet trajtuar dhe ta zvogëlojmë. Unë nuk jam ekspert i konferencave dhe nuk e di a janë të mira apo jo, ju e keni vlerësuar si bord këtë punë, mirëpo po më duken të larta.

Blerim Kuçi: Komisioni që kemi përballë është shumë i rëndësishëm për Kosovën, andaj duhet të kemi kujdes me rekomandimet, sepse lëmi i tyre është një prej shtyllave të zhvillimit ekonomik. Këta kanë nevojë të bëjnë prezantimin e pasurisë dhe duhet të jenë të kujdesshëm. Duhet të jenë më tolerantë në shfrytëzimin e shpenzimeve dhe të hyrave, por jo të ndalen këto vizita jashtë vendit, sepse promovimi është shumë me rëndësi.

Kryetari: Parimisht, rekomandimi i përgjithshëm është që të kursehet sa më shumë paraja publike dhe se këto vizita mos të shndërrohen në ekskursionë të institucioneve tona, por të jenë të punës dhe kur jemi te kursimi, është që të shkohet më pak njerëz në konferenca të tilla. Auditori, në të ardhmen, të ketë vëmendje të shtuar në këtë nënkategori të shpenzimeve.

Emine Fazliu: Mostrat që i kemi zgjedhur te ky nënkod, nuk kemi hasur ndonjë parregullsi ku pikërisht ky kod është rritur 10.000 euro, mirëpo është arsyetuar me nevojën për udhëtime jashtë vendit.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni për Kuvendin, unanimisht, nxori këtë

Rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017.

11. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Autoritetit Rregullator për Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017

Kryetari ia dha fjalën kryetarit të ARKEP, për një prezantim të shkurtër rreth pjesës financiare të raportit për vitin 2017 dhe më pas të hapim diskutimin.

Kreshnik Gashi: Niveli i implementimit të buxhetit ka qenë i mirë, ku në paga dhe mëditje janë shpenzuar 100%, mallra dhe shërbime 88%, kurse në shpenzime kapitale 92%. Gjatë periudhës raportuese, ARKEP-i ka mbledhur të hyra vetjake në vlerën 4.5 milionë euro dhe të gjitha të hyrat e mbledhura janë transferuar në buxhetin e Republikës së Kosovës. Sa i përket sfidave të ARKEP, fatkeqësisht vitin e kaluar ka qenë një problem teknik, edhe pse e kemi dërguar me kohë kërkesën buxhetore në komision, nuk jemi ftuar dhe sfidë kryesore ka mbetur dhe vazhdon të jetë numri i vogël i të punësuarve, krahasuar edhe me vendet e autoriteteve të ngjashme.

Kryetari njoftoi se kërkesa buxhetore nuk ka ardhur në komision.

Kreshnik Gashi: *Gjatë vitit 2017 është bërë një punë e madhe e ARKEP-it, në implementimin në kode shtetërore të telefonisë dhe janë konsultuar operatorët për sfidat e tyre gjatë implementimit. Po ashtu, është bërë një punë në aplikimin për kodin shtetëror të internetit. Një sfidë që është paraqit edhe në Raport të Progresit në Republikën e Kosovës, është edhe pavarësia buxhetore dhe institucionale e rregullatorit, sepse përveç Rregullores së BE-së, që kërkojnë një gjë të tillë, të hyrat e çdo rregullatori, praktikisht mbliidhen nga taksat për t'u kthyer në tregun që ajo rregullon, përmes investimeve, dhe përkundër që të hyrat i kemi 4.5 milionë euro në vit, shpenzimet janë gjithmonë nën 1 milion euro.*

Valbon Bytyçi: ZKA ka dhënë një raport të pamodifikuar, që nënkupton se pasqyrat financiare janë në gjendje të rregullt në të gjitha aspektet materiale. Në përgjithësi, ARKEP-i ka krijuar kontrole të mira, në raport me obligimet, e nëse krahasojmë me vitin paraprak, ka përmirësime të dukshme, sidomos tek pjesa e raportimit, përkatësisht tek të arkëtueshmet dhe pasuritë. Në vitin e kaluar kemi dhënë 8 rekomandime, prej tyre 5 janë adresuar dhe 3 janë në proces. Në këtë vit kemi dhënë 5 rekomandime, që kryesisht ndërliidhen me pjesën e personelit, ku ka qenë një e gjetur për ushtrues detyre, konkretisht edhe në vitin paraprak ka qenë ky rekomandim, ku ishte angazhuar një asistente si ushtruese, për gjashtë muaj, duke mos zhvilluar proceset e rekrutimit, dhe një rast tjetër, një vozitës ka qenë me kontratë të caktuar dhe është paguar prej mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, kemi një rekomandim tjetër lidhur me planifikimin fillestar të buxhetit, si dhe një tjetër në lidhje me menaxhimin e rreziqeve që nuk është monitoruar në përgjithësi në proces.

Kreshnik Gashi: Ne jemi pajtuar me rekomandimet, edhe pse kemi pasur disa diskutime me auditorin, dhe më tutje i kemi adresuar ato. Sa i përket ushtruesit të detyrës ka qenë e lidhur me një proces, i cili ka qenë në vazhdimësi, procesi i arkivimit, edhe pse koha prej tre muajsh për të drejtë ushtruesi detyre, është pothuajse e pamundur, për shkak të zgjatjes së procesit të rekrutimit. Te pozitat që kanë qenë në kohë të ndryshme jashtë listës së pagave apo të paguara nga mallrat dhe shërbimet, Bordi i ARKEP-it ka vendosur që ta formojë një kabinet për bordin dhe kryetarin e bordit, por pasi që kemi marrë rekomandimin e auditorit, i kemi ndërprerë ato kontrata e ato vetëm janë mbetje të vitit të kaluar. Ndërsa sa i përket menaxhimit të rreziqeve, ne kemi përgatitur regjistrin e rreziqeve, por nuk e kemi miratuar një menaxher të veçantë që të përkujdeset për këtë regjistër, por kemi konsideruar që një ndër departamentet të rishikohet.

Kryetari: Shtesa e prezantuar 6,000 euro për bordin, për çfarë shtese bëhet fjalë?

Kreshnik Gashi, sqaroi se kjo shtesë është për pagesën e mbledhjeve të bordit, e cila ndodh njëherë në muaj.

Kryetari: Mbi çfarë baze merren këto shtesa?

Kreshnik Gashi, sqaroi se këtë praktikë e kemi gjetur si të tillë, e ka një historik, për shkak se ne nuk kemi një ligj të veçantë që i përcakton pagat për të gjithë anëtarët e bordit.

Safete Hadërgjonaj: Paga e anëtarëve po del të jetë më e madhe se e deputetëve, ku anëtarët e bordit kanë rrogë 1761 euro, e ne e kemi pagën 1440 euro!

Kryetari: Kërkoj që bordi të rishikojë pagesën shtesë për mbledhjet e bordit dhe ta heqë atë, pasi që bordi paguhet për punën e tyre dhe nuk ka nevojë për shtesa tjera. Po ashtu, kërkoj që të njoftohet komisioni për heqjen e kësaj shtese. Kjo, natyrisht, nuk vlen vetëm për këtë institucion, por për të gjitha institucionet që të largohen këto shtesa, derisa të bien në zero, pra të ekzistojë vetëm paga.

Kreshnik Gashi: Ne do ta trajtojmë këtë çështjen e shtesës në bord dhe do t'iu njoftojmë me vendimin e bordit.

Fikrim Damka: Te shpenzimet jashtë vendit, më duket se është në disproporcion me mëditjet dhe akomodimet, sepse nuk mund të jetë pagesa e akomodimeve më pak se sa mëditja, 24.500 euro të jenë mëditje e akomodim 15.000 euro ose shumë shpesh keni shkuar në Shkup dhe e keni marrë një ditë tjetër. Andaj, të vërtetohet a është gabim teknik?

Safete Hadërgjonaj, pyeti përfaqësuesit e ZKA-së: Këtu, te shpenzimet për shërbime, që janë 75.524 euro, a keni gjetur ndonjë shkelje dhe sa është efekti dhe efikasiteti i shpenzimit të mjeteve te shpenzimet për shërbime? Sepse, po shihet se janë shtuar diku rreth 20.000 euro, krahasuar me vitin paraprak dhe po shihet që shërbime tjera kontraktuese janë 22.451 euro.

Valbon Bytyçi: U cek edhe më herët se auditimi mbulohet me mostra, për shkak se nuk mund të mbulohet 100% të totalit të shpenzimeve ose të hyrave. Të gjitha parregullsitë që i kemi vërejtur, i kemi raportuar në raportin tonë të auditimit. Lidhur me shpenzimet e mëditjeve, mund të ketë raste që shumë institucione që shpenzimet mbulohen prej donatorëve, përderisa mëditjet paguhen prej institucionit dhe kjo mundet të krijojë atë diferencën, ku mëditjen janë më të larta në raport me shpenzimet e akomodimit.

Kreshnik Gashi: Në fakt, te ne është e lidhur në shumë raste me shpenzimet e trajnimit, për shkak se trajnimet, shumica prej tyre, bëhen jashtë vendit. Gjithashtu, kemi pasur raste kur donatori i mbulon shpenzimet. Sa i përket Shkupit, askush nuk ka shkuar në vitin 2017. E kemi një problem se me disa procese të prokurimit, po shkon shumë ngadalë. Në Agjencinë Qendrore të Prokurimit janë vetëm dy persona që merren me këto institucione. Pra, kisha bë kërkesë që të trajtohet kjo çështje, sepse po na sjell probleme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni për Kuvendin, me shtatë vota për, një kundër dhe asnjë abstenim, nxori këtë

Rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit ë të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2017.

13. Të ndryshme

Safete Hadërgjonaj: Unë dua të ngre një çështje, që ka të bëjë me kryesuesin e Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator të Shërbimit të Ujit. Ky person është zgjidhur nga Kuvendi, më datën 28.10.2016 dhe deri më tani nuk ka marrë asnjë euro. Prandaj, dua ta shqyrtojmë këtë çështje dhe ky person të ketë mëditje, sepse është caktuar nga Kuvendi dhe ky i fundit është përgjegjës për caktimin e pagës së tij. Çështja e dytë ka të bëjë me ish-Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, i cili ka funksionuar në kuadër të Ministrisë së Financave.

Naser Osmani: Çështja e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime është shumë me rëndësi që të trajtohet, sepse nga një organ shumë kompetent i emëruar nga Kuvendi, si organ i shkallës së dytë në procedurën administrative, për t'i shqyrtuar ankesat pranë ATK-së dhe i cili ka kryer shumë punë. Ne ia kemi dhënë mundësinë që të kalojë si Divizion Fiskal pranë Gjykatës Themelore. Duke pasur parasysh se Gjykata Themelore është institucion që më tepër i njeh ngjarjet juridike të natyrës penale dhe civile, e çështjet financiare mbetën në dorën e një eksperti, prandaj duhet rikthyer dhe mendoj që komisioni duhet të marrë iniciativën për amendamentimin e ligjit.

Safete Hadërgjonaj: Me ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, që ka qenë edhe kërkesë e Komisionit Evropian, këtij bordi ia kemi dhënë mundësinë të rishqyrtojë lëndët e vjetra dhe të kalojë në Divizionin Fiskal në Gjykatën Themelore. Në vazhdimësi, i kemi ankesa që nuk po funksionon ky Divizion Fiskal dhe kemi kërkesa që t'i rikthyer prapë bordi. Mendoj që është mirë që të mbahet një takim edhe me ministrin e Financave dhe me personat kompetentë, në mënyrë që të shikojmë vetë se si ka shkuar rrjedha e shqyrtimit të lëndëve, pasi që nga bizneset ka ankesa për mosfikasitet të punës së divizionit.

Blerim Kuçi: Ndoshta, fillimisht duhet të ketë konsultë me ministrin e Financave, për të parë nëse kanë ndërmarrë iniciativën për ta ndryshuar ligjin, në mënyrë që mos të kemi dyfishim të aktiviteteve për të njëjtën çështje.

Kryetari konstatoi se komisioni vendosi që t'i dërgojë një shkresë ministrit të Financave, për të marrë informata, nëse ministria është në proces të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nëse pjesë e ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit është duke u trajtuar mundësia e rregullimit/kthimit ligjor të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime.

Kryetari: Sa i përket çështjes së kompensimit të pagës së kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullator të Shërbimit të Ujit, ligji thotë se për këtë person nuk ka marrëdhënie të rregullt pune dhe kompensimi i tij bëhet në bazë të angazhimit, sipas nevojës dhe paguhet nga buxheti i autoritetit.

Safete Hadërgjonaj: Si person i caktuar nga Kuvendi, ne duhet t'ia caktojmë një kompensim për angazhimin e tij. Një anëtar i kaluar kishte dhënë dorëheqje, sepse nuk ishte kompensuar asnjëherë. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, thotë se ne e bëjmë pagesën, mirëpo shuma e kompensimit duhet të përcaktohet nga Kuvendi. Propozoj që t'i ftojme ata në një takim dhe ta trajtojmë këtë çështje.

Kryetari: Kemi edhe dy kërkesa tjera. E para ka të bëjë me kërkesën e Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për caktimin e shumës së pagesës për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarë të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona, të zgjedhur nga Kuvendi. Pra, është kërkesa që në mbledhjen e fundit e kemi hequr prej rendit të ditës, për të marrë informata krahasuese me komisionet tjera të ngjashme. Sa për informacion, Bordi Mbikëqyrës në këtë Agjenci paguhet 500 euro kompensim fiks. Çështja e dytë ka të bëjë me përzgjedhjen e pesë anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, që do të zgjidhen nga Kuvendi, në bazë të ligjit përkatës. Por, Administrata e Kuvendit nuk po mund të shpallë konkursin, pa e ditur shumën e kompensimit të tyre. Prandaj, ne duhet të dalim me një propozim edhe për këtë çështje.

Safete Hadërgjonaj: Propozoj që në mbledhjen e radhës, të ftohen përfaqësuesit e agjencisë, që të na njoftojnë më tepër për punën e këtyre komisioneve, para se komisioni të dalë me ndonjë rekomandim për kompensimin e tyre.

Naser Osmani: Niveli i kompensimit të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, të jetë ekuivalent me anëtarët e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Mund të krahasohen edhe pagat e anëtarëve të OSHP-së dhe KRPP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit.

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku